



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD
KËSHILLI BASHKIAK

**Komisioni i Përhershëm i Veprimtarisë Ekonomike, Financiare, Buxhetit, Pronës dhe i
Zënies me Punë**

RAPORT VENDIMMARRJE

Nr.3 datë 28/07/2025

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit **“Përdorim fondi rezervë për
“Bashkëfinancimin e projektit Përmirësimi i banesave ekzistuese për
komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara”**.

Analiza ligjore: Projekt-vendimi është i mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen
vendore” dhe në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”,ligjin
nr.115/2024”Për buxhetin e vitit 2025”

Situata aktuale e funksionit Propozimi dhe miratimi i këtij vendimi është kërkesë e Ligjit nr.
68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” dhe si e tillë ai vjen në kohën e duhur në zbatim
të ligjit.

Situata financiare : Projekti prezanton të gjitha familjet të cilat kanë përfituar nga projekti i
strehimit për vitin 2025 nga Ministria e Ekonomisë,Kulturës dhe Inovacionit dhe
bashkëfinancim me Bashkinë Librazhd.

Drejtoria / Sektori përgjegjës – Drejtoria e Buxhetit, Menaxhimit Financiar dhe Çeshtjeve
Sociale , Drejtoria e Planifikimit Kontrollit të Territorit dhe Pronës.

Monitorimi dhe raportimi : Drejtoria e Buxhetit, Menaxhimit Financiar dhe Çeshtjeve Sociale
monitoron fondet, Drejtoria e Planifikimit Kontrollit të Territorit dhe Pronës monitoron
mbarëvajtjen e punimeve dhe bën raportimet në Ministria e Ekonomisë,Kulturës dhe Inovacionit.

Impakti social / grupet që preken: Rritja e cilësisë së jetesës si dhe rritjen e sigurisë në
banesat e përfituesve të projektit , mbështetja e familjeve në nevojë.

A është objekt i konsultimit publik: Projekt-vendimi ka qënë objekt i konsultimit publik në zbatim të Ligjit 139/2015, realizuar nga Këshilli dhe Kryetari i bashkisë.

" Komisoni i Përhershëm i Veprimtarisë Ekonomike, Financiare, Buxhetit, Pronës dhe i Zënies me Punë " , i mbledhur me datën 28/07/2025 shqyrtoi projekt vendimit "Përdorim fondi rezervë për "Bashkëfinancimin e projektit Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara", relacionin dhe dokumentat shoqërues paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese, Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak: **Miratimin e projektaktit**

Bashkëlidhur procesverbali i mbledhjes së Komisionit

Zenei Bahiti Kryetar i Komisionit

(emri, mbiemri, firma)



Ndriciu Doko Sekretar i Komisionit

(emri, mbiemri, firma)

Datë 28/07/2025